# Republika e Kosovës

**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 4 QERSHOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 4. JUNA 2009. GODINE

KORRIK – JUNI
2009

T R A N S K R I P T

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT:
Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare!
I hapim punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë prezent 101 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6 pikë 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, Kryesia ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme.

Rendin e ditës e keni marrë dhe pikë e vetme e rendit të ditës është:

- **Zgjedhja e Avokatit të Popullit**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me Rregulloren për Procedurë të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit ka shqyrtuar propozimin e Panelit raportues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emrat e tre kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit, të renditur sipas alfabetit të mbiemrit, Rregulla 9.7 e procedurave për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Rekomandimi i Komisionit dhe materiali shtesë u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni që të shpjegojë procesin e rekrutimit të kandidatëve dhe të arsyetojë rekomandimin e Komisionit.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuari zoti Kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi, duke u bazuar në nenin 134 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 9 të Rregullores së Kuvendit për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit, pas përfundimit që kemi marrë nga Kryesia e Kuvendit më 31 mars 2009, ku Kryesia e Kuvendit ka autorizuar dy komisione funksionale: Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi dhe Komisionin për të Drejta dhe Liri të Njeriut, Persona të Pagjetur dhe Peticione që së bashku të formojnë një panel rekrutues për të selektuar dhe për të intervistuar kandidatët e mundshëm për Avokat të Popullit.

Komisioni, duke u mbështetur në Rregulloren e Punës të Kuvendit dhe në Rregullën 3 për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, ka formuar brenda afatit të paraparë këtë komision dhe ka vendosur që Komisionin ta drejtojë njëri nga anëtarët e Komisionit për Legjislacion, zoti Ibrahim Makolli, që vjen nga radhët e AKR-së, nga opozita.

Në përbërje të Komisionit kanë qenë nga një anëtar i të gjitha grupeve parlamentare.

Paneli rekrutues, në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e Komisionit rekrutues, duke u mbështetur në rregullat e punës dhe sidomos në Rregullën 7, ka hartuar kriteret të cilave iu është dashur t'i përgjigjen kandidatët gjatë intervistës.

Kriteret janë hartuar në bashkëpunim edhe me ekspertë të Zyrës së Komisariatit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Zyrës së Sekretariatit të Këshillit të Evropës dhe me rastin e intervistimit të kandidatëve janë aplikuar këto kritere në mënyrë unike.

Të gjitha intervistat janë zhvilluar në seanca të hapura, kanë pasur mundësi të marrin pjesë të gjithë ata të cilët janë interesuar se si po procedohet dhe si po zhvillohet intervista për Avokat të Popullit.
Në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, deri në momentin e rekomandimit nuk kemi pranuar asnjë shkresë ku ka pasur ndonjë vërejtje rreth procesit të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit.

Vlen të përmendet se procesi është përcjellë edhe nga Shoqëria Civile, nga OSBE, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, përfaqësuesit e EULEX-it, Zyrës Civile Ndërkombëtare dhe të gjithë ata të cilët kanë qenë të interesuar.

Paneli rekrutues në kohën e përcaktuar ka bërë rekomandim në Komisionin për legjislacion dhe gjyqësi në bazë të meritave dhe në bazë të përvojës dhe intervistave që kanë treguar kandidatët gjatë marrjes në intervistë.

Më 18 maj 2009, Komisioni i ka shqyrtuar rekomandimet e Panelit rekrutues dhe në mënyrë unanime ka konstatuar se procedurat kanë qenë në rregull me rastin e intervistimit të kandidatëve dhe se Paneli rekrutues ka propozuar tre kandidatë, të cilët kanë treguar sukses më të mirë nga kandidatët tjerë dhe duke u mbështetur në rregullat 9.4 dhe 9.7 të Rregullave për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, kësaj seance plenare i propozon këta tre kandidatë:

- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani, dhe
- Veton Vula.

Të nderuar kolegë deputetë,
Është hera e tretë vetëm në këtë legjislaturë që Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka bërë rekomandime për këtë seancë plenare për kandidatët e mundshëm për Avokat të Popullit.

Duke kuptuar rëndësinë që ka ky institucion për Kosovën dhe qytetarët e saj, duke kuptuar rëndësinë që ia ka dhënë edhe vetë akti më i lartë juridik -Kushtetuta e Kosovës, kishim kërkuar që sot deputetët e Kuvendit të Kosovës të votojmë për njërin nga kandidatët që sot ta marrë dhe drejtojë institucionin i cili për një kohë të gjatë po ushtrohet nga ushtrues detyre dhe duke marrë parasysh se është i vetmi institucion i cili do t'i mbrojë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, nëse ata atakohen në forma të ndryshme nga vendime të ndryshme qeveritare.

Unë shfrytëzoj rastin që të gjithë anëtarët e të dy komisioneve t'i falënderoj dhe në veçanti falënderoj kryesuesin e Panelit rekrutues, stafin mbështetës të Komisionit dhe kandidatëve të sapo propozuar iu uroj sukses. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Të nderuar deputetë,
Ju njoftoj se votimi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit është i fshehtë dhe deputeti ka mundësi të votojë për njërin nga kandidatët e propozuar nga Komisioni.

Për zbatimin e procedurës së votimit, ftoj shefat e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues. Por, para se t'i ftoj shefat e grupeve, ju njoftoj se Grupi Parlamentar "Zajedno" që është formuar para pak kohës është shpërbërë pasi që një nga anëtarët e atij Grupi është tërhequr nga Grupi.

Sipas radhës, fjalën e ka Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,
Nga Grupi Parlamentar propozohet Elheme Hetemi.

KRYTARI: Faleminderit! Radha është e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetit Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Ne propozojmë në Komision, zotin Armend Zemaj.

KRYETARI: Radha është e Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetit Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: I nderuari Kryetar,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar kolegë,
Nga Grupi Parlamentar i AKR-së propozojmë deputeten Suzan Novobërdali.

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Grupi ynë Parlamentar e propozon deputetin Rasim Selmanaj në Komision.

KRYETARI: Faleminderit! Shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Grupi Parlamentar i LDD-së propozon deputetin Naser Rugova.

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar "7+". Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Pozdravljam vas, Predsedniče!
Premijera, zamenike i kolege,
Parlamentarna Grupa „7+" predlaže za ovu komisiju poslanika Enisa Kervana.

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të LSL-së, deputetit Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!
Parlamentarna Grupa LSL u Komisiji predlaže narodnog poslanika, gospodina Etem Arifi.

KRYETARI: Faleminderit!
Konstatoj se Komisionin votues e përbëjnë:

- Elheme Hetemi,
- Armend Zemaj,
- Suzan Novobërdali,
- Rasim Selmani,
- Naser Rugova,
- Enis Kervan, dhe
- Etem Arifi.

Komisioni votues do të mbështetet edhe nga 2 zyrtarë të Administratës së Kuvendit.

Ftoj deputetët që, sipas ftesës nga lista, t'i marrin fletëvotimet e tyre.

Ftoj deputetët sipas rendit alfabetik, për të votuar:

- Adem Grabovci,
- Adem Hajdaraj.

- Adem Salihaj,
- Agim Veliu.

- Ahmet Isufi,
- Ali Lajçi,
- Alush Gashi.

- Anita Morina,
- Ardian Gjini.

- Armend Zemaj,
- Arsim Bajrami.

- Arsim Rexhepi,
- Bahri Hyseni.

- Bajram Kosumi,
- Behgjet Pacolli,
- Berat Luzha.

- Berim Ramosaj,
- Besa Gaxherri,

- Bojan Stojanoviq.

- Branisllav Gërbiq,
- Bujar Bukoshi.

- Danush Ademi,
- Donika Kada.

- Dragisha Miriq,
- Drita Kadriu,
- Drita Maliqi.

- Driton Tali,
- Xhezair Murati.

- Edita Tahiri,
- Elheme Hetemi.

- Emrush Xhemajli,
- Enis Kervan.

- Enver Hoxhaj,
- Eqrem Kryeziu.

- Esat Brajshori,
- Etem Arifi.

- Ethem Çeku,
- Fatmir Limaj.

- Fatmir Rexhepi,
- Fatmire Berisha.

- Fehmi Mujota,
- Flora Brovina.

- Gani Buçinca,
- Gani Geci.

- Gani Koci,
- Gjylnaze Syla.

- Hafize Hajdini,
- Hajdin Abazi.

- Haredin Hyseni,
- Hajredin Kuçi.

- Haki Shatri,
- Hashim Thaçi.

- Heset Cakolli,
- Hydajet Hyseni-Kaloshi.

- Ibrahim Gashi,
- Ibrahim Makolli.

- Ibrahim Selmanaj,
- Ismet Beqiri.

- Jakup Krasniqi,
- Kaqusha Jashari.

- KRYESON SABRI HAMITI:

- Kolë Berisha,
- Kosara Nikoliq.

- Dragan Dimiq,
- Luljeta Shehu.
- Lulzim Zeneli.

- Lutfi Haziri,
- Mahir Jagxhillar.

- KRYETARI:

- Mark Krasniqi,
- Melihate Tërmkolli.

- Memli Krasniqi,
- Mihajllo Shqepanoviq,
- Mimoza Ahmeti.

- Mufera Shinik,
- Murselj Haljilji.

- Myrvete Pantina,
- Muzejene Selmani,
- Naim Maloku.

- Naim Rrustemi,
- Nait Hasani.

- Naser Osmani,
- Naser Rugova.

- Nekibe Kelmendi,
- Nerxhivane Dauti.

- Nexhat Daci,
- Njomza Emini.

- Numan Baliq,
- Nurishahe Hulaj. Nuk është këtu.
- Qamile Morinaj.

- Radmilla Vujoviq,
- Ramadan Avdiu.

- Ramadan Gashi,
- Ramë Buja.

- Ramë Manaj,
- Rasim Selmanaj.

- Rita Hajzeraj,
- Riza Smaka.

- Rrustem Mustafa,
- Sabri Hamiti.

- Sadik Idriz,
- Safete Hadërgjonaj.

- Sala Berisha-Shala,
- Sanije Aliaj.

- Selvie Halimi,
- Shkumbin Demaliaj.

- Skender Hyseni,
- Sllavisha Petkoviq,
- Sllobodan Petroviq.

- Shpresa Murati,
- Suzan Novobërdaliu.

- Synavere Rysha,
- Teutë Hadri.

- Vezira Emrush,
- Vlladimir Todoroviq,
- Vlora Çitaku,
- Xhavit Haliti.

- Xhevdet Neziraj.

- Zafir Berisha.

- Zef Morina.

- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Veton Vula,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Besnik Osmani,
- Veton Vula,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Veton Vula,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- E pavlefshme.
- Veton Vula,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- E pavlefshme,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,

- Veton Vula,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani,
- Besnik Osmani,
- Besnik Osmani,
- Veton Vula,
- Besnik Osmani,
- Besnik Osmani,
- Sami Kurteshi,
- Sami Kurteshi,
- Besnik Osmani.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Ju lutem i zëni vendet tuaja.
Ftoj kryetarin e Komisionit votues t'i paraqet rezultatet e votimit.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Raporti për rezultatet e votimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Në mbështetje të nenit 134.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të të Rregullës 11 të Rregullave të Procedurës së Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësavokatët e Avokatit të Popullit Numër 02-3461, datë 21.06.2007,

Komisioni votues, në përbërje nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare:

- Elheme Hetemi, Grupi Parlamnetar PDK;
- Armend Zemaj, Grupi Parlamentar LDK,
- Suzan Novobërdali, Grupi Parlamentar AKR,
- Rasim Selmani, Grupi Parlamentar AAK,
- Naser Rugova, Grupi Parlamentar LDD,
- Enis Kervan, Grupi Parlamentar "7+", si dhe
- Etem Arifi, Grupi Parlamentar SLS.

Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, me votim të fshehtë të deputetëve të Kuvendit të Kuvendit të Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 4 qershor 2009, pas numërimit të votave, konstaton sa vijon:

- Në votim kanë marrë pjesë 107 deputetë.

- Për Sami Kurteshin kanë votuar 65 deputetë.

(Duartrokitje)

- Për Besim Osmanin kanë votuar 27 deputetë.
- Për Veton Vulën kanë votuar 10 deputetë.

- Të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit të parë, në pajtim me nenin 134, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Rregullës 11 të Rregullave të Procedurës të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të Rregullës 31 pikë 3 të Rregullores së Punës të Kuvendit, konstatojmë se zoti Sami Kurteshi zgjedhet Avokat i Popullit me mandat 5-vjeçar, pa të drejtë të rizgjedhjes. Sukses!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Konstatoj se Kuvendi zgjodhi Avokat të Popullit Sami Kurteshin me votim të fshehtë dhe me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me 65 vota "për" për një mandat 5-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Ftoj kandidatin e porsazgjedhur Avokat të Popullit, Sami Kurteshin, që ta bëjë betimin solemn para Kuvendit të Republikës së Kosovës.

SAMI KURTESHI: Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
Të nderuar anëtar të Kabinetit qeveritar,
Falënderoj për besimin e dhënë.

- Solemnisht deklaroj dhe premtoj se me besnikëri do t'i kryej detyrat dhe funksionet që më janë besuar me Kushtetutë e ligj për t'i mbrojtur e avancuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në Republikën e Kosovës, se do t'i kryej detyrat e mia në tërësi e në mënyrë të paanshme dhe se nuk do të kërkoj apo të marrë udhëzime prej ndonjë burimi të jashtëm.

- Svećano izjavljujem i obećavam da ću pošteno obavljati dužnosti i funkcije koje su mi poverene Ustavom i Zakonom o zaštiti i promovisanju ljudskih prava i osnovnih sloboda u Republici Kosova, da ću u potpunosti obavljati svoje dužnsoti nepristrasno i da neću tražiti ili primati uputstva od bilo koje treće strane.

- I solemly declare and promise to faithfully discharge the duties and functions entrusted to me by Constitution and Law to protect and promote human rights and fundamental freedoms in Republic of Kosovo, to perform my duties thoroughly and impartially and not to seek or accept instructions from any outside source.

(Duartrokitje)

KRYETARI: Me betimin e Avokatit të Popullit, mbyllim seancën e sotme plenare.

Përgatiti:
**Njësia e Transkripteve**